



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT LUMOR SEMAN

VENDIM

Nr.1, datë 13.03.2026

PËR

MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM BURIMI UJOR”
ME QËLLIM SHFRYTËZIMIN E MATERIALEVE INERTE QË
NXIRREN NGA SHTRETËRIT E LUMENJVE, PËRRENJVE, LIQENEVE,
ME OSE PA UJË, ME VENDNDODHJE: SHTRATI I LUMIT DEVOLL,
BASHKIA CËRRIK, QARKU ELBASAN,
TË SUBJEKTIT “VËLLEZËRIT HYSA” SH.P.K.

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore”, i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.319, datë 11.06.2025, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Seman,

V E N D O S I.

1. Miratimin e lejes “Për përdorim burimi ujor”, me qëllim shfrytëzimin e materialeve inerte që nxirren nga shtretërit e lumenjve, përrenjve, liqeneve, me ose pa ujë me vendndodhje: Shtrati i Lumit Devoll, Bashkia Cërrik, Qarku Elbasan, subjektit “Vëllezërit Hysa” sh.p.k, për zbatimin e projektit “Ndërhyrje për rigjenerimin urban, mbrojtje detare në zonën bregdetare: Riprofilimi dhe mbushja me rërë e vijës bregdetare nga Ura e Dajlanit deri tek Godina e Kavalishencës, Durrës”, sipas kontratës me FSHZH-në, Referenca P/Punë 2025/IVR27, me Nr. 684 prot, datë 18.02.2025.

4. Volumi i materialit të kërkuar : **285 000 m³**;



5. Subjekti të respektojë të gjitha sygjërimet e dhëna nga AKM-ja dhe SHGJSH-ja;
6. Shfrytëzimi i inerteve duhet të jetë 0.6m mbi nivelin maksimal të pasqyrës së lumit dhe 25-50m nga rryma e ujit dhe argjinatura;
7. Subjekti duhet të raportojë çdo muaj pranë ZABL Shkumbin-Seman për volumin e materialit të nxjerr nga shtrati;
8. Të ndiqet nga ZABL Shkumbin-Seman zbatimi i projektit të rehabilitimit;
9. Të mos depozitohet material stok në brigjet e shtratit pas përfundimit të kësaj leje;
10. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi;

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBL SEMAN

ANDUEL XHINDI

